



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:303911
Datë: 04.03.2024
Numri i dokumentit: 05407590

C.nr.5326/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit O.D. i mitur, me përfaqësues ligjor babai A.D. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "ELSIG" me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit si pasojë e lëndimeve, me vlerë të kontestit 1.500,00€, jashtë seance, me datë 04 Mars 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET së është tërhequr padia me numër C.nr.5326/2023, paditësit O.D. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "ELSIG" me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen juridike kompensim dëmi.

A r s y e t i m

Paditësit O.D. i mitur, me përfaqësues ligjor babai A.D. nga Prizreni, të cilin me autorizimit e përfaqëson av. D.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 29.12.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "ELSIG" me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të demit jomaterial, me vlerë të kontestit 1.500,00€.

I autorizuari i paditëses përfaqëson av. D.M. nga Prizreni, me parashtresën e datës 01.03.2024, e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë e paditësit për shkak të mungesës së interesit juridik të palës për vazhdimin e procedurës.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore 03/L-006, vendosi si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2023:303911
Datë: 04.03.2024
Numri i dokumentit: 05407590

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.5326/2023 datë 04 Mars 2024

Gjyqtari

Gëzim Shehu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, bazuar në nenin 261.4 të LPK-së.